



Viti i XIV -të i Botimit, Nr.1,  
Qershor 2022

## VLERËSIMI I NJOHURIVE, QËNDRIMEVE DHE SJELLJEVE RRETH HIV/AIDS TEK STUDENTËT E ALBANIAN UNIVERSITY

Lumturi Merkuri\*, Erda Qorri\*\*

\* Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë, Albanian University

\*\* Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Albanian University

Adresë kontakti: [lmerkuri@hotmail.com](mailto:lmerkuri@hotmail.com)

### Përmbledhje

**Hyrje:** Të rinjtë 15-24 vjeç janë veçanërisht vulnerabël ndaj infeksionit HIV duke mbetur në qendër të pandemisë HIV/AIDS. Pavarësisht progresit të bërë globalisht dekadën e fundit, me një rënie prej 46% të infeksioneve të reja HIV tek të rinjtë 15-24 vjeç, dy nga shtatë infeksione të reja HIV në 2019, ishin të rinjtë 15–24 vjeç dhe vdekjet e lidhura me HIV në këtë grupmoshë vlerësohen të jenë 46.000. Njohuritë e pakta, qëndrimet e padëshiruara e praktikatat e rrezikshme ndër të rinjtë, janë ndër pengesat kryesore për të parandaluar transmetimin e HIV-it dhe përhapjen e kësaj epidemie.

**Qëllimi:** Të vlerësohet niveli i njohurive, qëndrimeve dhe sjelljeve të studentët e Albanian University mbi HIV/AIDS.

**Metodologjia:** Një studim online u krye te studentët e Albanian University gjatë periudhës shkurt-qershor 2021 për të mbledhur informacion nëpërmjet një pyetësores të strukturuar i cili u plotësua me vetadministrim nga 634 studentë.

**Rezultatet:** Studentët demonstruan njohuri të kënaqshme mbi rrugët e transmetimit të HIV, por 15.2% mendojnë se HIV transmetohet nga kontakti i përditshëm me persona të infektuar. Rreth 26% raportuan se përdorin gjithmonë prezervativ gjatë marrëdhënieve seksuale, 39% nuk përdorin asnjëherë e 35% e përdorin me raste. 66.2% nuk kanë përdorur prezervativ gjatë marrëdhënies së fundit seksuale e 54% e kanë përdorur për të parandaluar një shtatzëni. Shumica (89%) preferojnë farmacitë për të siguruar prezervativ dhe 9.3% nuk dinin ku ti siguronin. Testin për HIV nuk e kanë kryer 90.1% e studentëve pjesëmarrës në studim dhe 32.2% nuk dinë ku të drejtohen. Rreth 14% e studentëve janë përgjegjës se do ta mbanin të fshehtë statusin HIV pozitiv, 9% mendojnë se personat HIV pozitiv duhen izoluar e 11% raportuan se nuk duhen lejuar të frekuentojnë shkollën.

**Konkluzione:** Studentët kishin nivel të kënaqshëm njohurish mbi HIV/AIDS, megjithatë, kishte keqkuptime, qëndrimet intolerante e diskriminuese ndaj personave HIV pozitiv e praktika seksuale të rrezikshme. Sjelljet me rrisht të lartë ishin të zakonshme tek studentët e intervistuar. Programet që synojnë ofrimin e informacionit që mund të parandalojnë transmetimin e HIV te të rinjtë dhe strategji të reja për përmirësimin e njohurive duhet të theksohen prioritet i shëndetit publik.

**Fjalët çelës:** HIV/AIDS, student, njohuri, qëndrime, sjellje, parandalim

## ASSESSMENT OF KNOWLEDGE, ATTITUDES AND BEHAVIORS ABOUT HIV/AIDS AMONG ALBANIAN UNIVERSITY STUDENTS

### Abstract

**Introduction:** Young people aged 15-24 are particularly vulnerable to HIV infection and remaining at the center of the HIV/AIDS pandemic. Despite the progress made over the last decade, 46% of new HIV infections are among 15–24 year olds, and two of the seven new HIV infections globally, in 2019 were among 15-24 year. Lack of knowledge, unwanted attitudes, and dangerous practices among young people, are among the main obstacles to prevent the transmission of HIV and the spread of this epidemic.

**Aim:** To assess the level of knowledge, attitudes and behaviors of Albanian University students on HIV / AIDS in order to design appropriate information-education-communication programs based on evidence.

**Methodology:** An online study was conducted on Albanian University students during the period February-June 2021 through a structured questionnaire which was completed with self-administration by 634 students, who were informed in advance on confidentiality.

**Results:** Students demonstrated satisfactory knowledge on the routes of HIV transmission, but 15.2% think that HIV is transmitted by daily contact with infected persons. About 26% reported that they always use a condom during sexual intercourse, 39% never use it and 35% use it occasionally. 66.2% have not used a condom during the last sexual intercourse and 54% have used it to prevent a pregnancy. Most (89%) prefer pharmacies to provide condoms and 9.3% did not know where to get them. 90.1% of the students participating in the study did not take the HIV test and 32.2% do not know where to go. About 14% of students answered that they would keep their HIV positive status a secret, 9% think that HIV positive people should be isolated and 11% reported that they should not be allowed to attend school.

**Conclusions:** The students had a satisfactory level of knowledge about HIV/AIDS, however, there were misunderstandings, intolerant and discriminatory attitudes towards HIV-positive persons and dangerous sexual practices. High-risk behaviors such as not using a condom during sexual intercourse were common among the students interviewed. Programs aimed at providing information that can prevent / reduce the transmission of HIV to young people and new strategies for improving knowledge should be highlighted as a public health priority.

**Keywords:** *HIV / AIDS, student, knowledge, attitudes, behavior, prevention*

## Hyrje

Megjithëse prej fillimit të epidemisë së HIV/AIDS kanë kaluar gati katër dekada, HIV vazhdon të jetë një problem global i shëndetit publik. Rreth 79.3 milion njerëz janë infektuar me HIV qysh nga fillimi epidemisë dhe 36.3 milion jetë kanë humbur. Të dhënat më të fundit globale raportojnë se në vitin 2020 kishte 37.7 milion njerëz që jetonin me HIV, 1.5 milion infektive të reja dhe 680 000 njerëz vdiqën nga sëmundjet e lidhura me AIDS. Rreth 6.1 milion njerëz nuk e dinin që jetonin me HIV <sup>(1)</sup>.

Shqipëria megjithëse vazhdon të mbetet një vend me prevalencë të ulët të infeksionit HIV, (rreth 0.046%), ka një tendencë në rritje të rasteve me HIV. Bazuar në të dhënat e Institutit të Shëndetit Publik, 2019, numri total i rasteve me infeksionin HIV është 1298, me 93 raste të reja për 2019. Nga totali i rasteve, 115 raste i përbëjnë të rinjtë, 16-24 vjeç. Rruga seksuale e transmetimit të virusit HIV vazhdon të dominojë në Shqipëri, e cila konstatohet në afërsisht 95 % të rasteve, me një tendencë vitet e fundit të rritjes së numrit të meshkujve që kryejnë seks me meshkuj <sup>(2)</sup>. Rritja e aksesit në parandalim, diagnostikim e trajtim e ka bërë HIV një gjendje shëndetësore kronike. UNAIDS ka propozuar objektivat globale të përditësuara për vitin 2025, të cilat synojnë që 95% e atyre që jetojnë me HIV të dinë statusin HIV pozitiv, 95% e atyre që dinë statusin HIV pozitiv të marrin trajtim dhe tek 95% e atyre që marrin trajtim të frenohet veprimi i virusit - objektivi 95-95-95<sup>(3)</sup>. Ndër përgjigjet globale ndaj epidemisë së HIV është dhe përfshirja te objektivi 3 i zhvillimit të qëndrueshëm/ SDG-3, i një objektivi për t'i dhënë fund epidemisë së HIV/AIDS deri në vitin 2030 <sup>(4)</sup>.

Të dhënat tregojnë se të rinjtë 15-24 vjeç janë veçanërisht vulnerabël ndaj infeksionit HIV duke mbetur në qendër të pandemisë HIV/AIDS. Pavarësisht progresit të bërë në dekadën e fundit, me një rënie prej 46% të infeksioneve të reja me HIV tek të rinjtë e moshës 15-24 vjeç, bota është ende prapa në arritjen e objektivave të vendosura për të rinjtë. Sipas UNAIDS, dy nga shtatë infeksione të reja HIV në 2019, globalisht ishin te të rinjtë 15–24 vjeç dhe vdekjet e lidhura me HIV vlerësohen të jenë 46 000 <sup>(5)</sup>.

Njohuritë e pakta, qëndrimet e padëshiruara e praktikave të rrezikshme janë ndër pengesat kryesore për të parandaluar transmetimin e HIV dhe përhapjen e kësaj epidemie. Rritja e ndërgjegjësimit, ndryshimi i qëndrimeve dhe modifikimi i sjelljes lidhur me HIV/AIDS shërbejnë si gurë themeli në luftën kundër HIV për të promovuar qëndrime pozitive dhe për të ndryshuar sjelljet drejt praktikave të sigurta <sup>(6)</sup>.

Në nivel global, vetëm një në tre të rinj demonstron njohuri të sakta për parandalimin e HIV. Qasja në programe gjithëpërfshirëse të edukimit seksual me cilësi të lartë, të përshtatshme për moshën, si në shkollë ashtu dhe jashtë shkollës, duhet të forcohet që të rinjtë të kenë njohuritë që u nevojiten për të parandaluar infeksionet e reja me HIV <sup>(5)</sup>.

Të rinjtë janë grupi kryesor i rrezikuar nga HIV/AIDS në të gjithë botën për shkak të faktorëve të tillë si kurioziteti, presioni i bashkëmohatarëve, mungesa e njohurive, seksi i pambrojtur, seksi me shumë partnerë dhe abuzimi me drogën. Studime të shumta kanë treguar se të rinjtë universitarë, kanë sjellje më të rrezikshme që i ekspozojnë ata nga HIV, sesa të rinjtë e tjerë. Ndryshimi i qëndrimit ndaj seksualitetit - pasja e partnerëve të shumtë seksual, seksi paramartesor në rritje dhe gjerësisht i pranuar tek të rinjtë, së bashku me mungesën e njohurive të lidhura me HIV/AIDS-n, janë disa nga arsyet që i bën ata të çënueshëm ndaj infeksionit HIV <sup>(7)</sup>.

Studime të kryera për vlerësimin e njohurive, qëndrimeve e sjelljeve tek studentët kanë gjetur se njohuritë e studentëve në lidhje me HIV ishin të pamjaftueshme, me keqkuptime mbi praktikave të rrezik të lartë si dhe një qëndrim negativ ndaj PLHIV. Keqkuptime janë gjetur në shumicën e studimeve KAP të kryera midis të rinjve <sup>(8,9)</sup>.

Qëllimi i këtij studimi ishte të vlerësohej niveli aktual i njohurive, qëndrimeve e sjelljeve të studentëve të Albanian University lidhur me HIV/AIDS në funksion të hartimit të programeve të përshtatshme të Informim-Edukim-Komunikimit bazuar në evidenca.

## Metodologjia

Instrumenti i mbledhjes së të dhënave ishte një pyetësor i strukturuar i hartuar për të grumbulluar informacion mbi njohuritë, qëndrimet e sjelljet e studentëve lidhur me HIV/ AIDS. Studimet **KAP** (Knowledge, Attitude and Practise) janë metodat më të përdorura veçanërisht në fushën e shëndetit publik për të identifikuar nivelin e njohurive, mitet, keqkuptimet, qëndrimet e sjelljet në një popullatë të caktuar lidhur me një temë specifike mbi shëndetin <sup>(10,11)</sup>. Pyetësori u vetëadministrua në platformën online nga 634 studentë, gjatë periudhës shkurt qershor 2021 të cilët u informuan paraprakisht se informacioni i marrë do të mbahej në mënyrë konfidenciale. Sondazhet online ofrojnë mundësi unike për kërkime në epokën e COVID-19, për shkak të mbledhjes së informacionit në kohë reale, kosto efektivitetit, përfshirjes së një numri më të madh të intervistuarish dhe për disa çështje të ndjeshme si studimi ynë (praktikat seksuale), njerëzit mund të preferojnë një anketë në internet sesa një pyetësor të administruar personalisht <sup>(12,13,14)</sup>. Për hartimin e pyetësorit u konsultuan modele pyetësorësh të përdorur për studime të ngjashme.

## Rezultatet dhe diskutimi

Në këtë studim morën pjesë 634 studentë, 83.8% femra dhe 16.2% meshkuj. Raporti në favor të femrave është në proporcion me numrin më të lartë të studenteve frekuentuese femra. Mosha mesatare e subjekteve në studim ishte  $22 \pm 1.5$  vjeç. Përqindja e pjesëmarrjes sipas departamenteve shkon paralelisht me numrin e studentëve në departamentet respektive: infermieri 69.4%, fizioterapi 12.8%, farmaci 14.4% dhe stomatologji 3.5%. Nga analiza e të dhënave konstatohet se subjektet në studim kishin një nivel të kënaqshëm njohurish mbi HIV/AIDS, 99% e tyre raportuan se kanë dëgjuar për HIV/AIDS. Niveli i informacionit mbi rrugët e transmetimit të HIV është i kënaqshëm për të gjitha rrugët e transmetimit. Frekuenca më e lartë e përgjigjeve korrekte ishte për transmetimin gjatë marrëdhënieve seksuale pa prezervativ, e raportuar nga një përqindje e lartë e studentëve (94%). Transmetimi nga transfuzioni i gjakut të infektuar raportohet nga 64.7% e të intervistuarve dhe rruga nga nëna tek fëmija, raportohet nga 56.6% e tyre.


Megjithëse njohuritë mbi rrugët e transmetimit janë relativisht të kënaqshme, nga analiza e të dhënave rezultoi se ka keqkuptime lidhur me to. Rreth 15.2% e studentëve mendojnë se HIV mund të transmetohet edhe gjatë kontaktit të përditshëm me persona të infektuar (takimi i duarve, frekuentimi i shkollës së bashku, përqafimet, etj). Ky mendim i gabuar bëhet shkak për qëndrime stigmatizuese dhe diskriminuese për të infektuarit me HIV duke kontribuar në përhapjen e epidemisë. Një përqindje relativisht e ulët e studentëve kanë informacion jo të saktë lidhur me grupet më të riskuara për t'u prekur nga HIV. Kështu, të pyetur se “kush mund të preket nga HIV/AIDS”, 3.3% e subjekteve në studim raportuan se preken vetëm gratë, 2.4% mendojnë se preken vetëm burrat, por shumica e tyre, 94.3%, mendojnë se preken të gjithë pa përjashtim.

Nga analiza e të dhënave lidhur me qëndrimet e të intervistuarëve, u konstatua se keqkuptimet dhe stigma sociale janë ende të përhapura tek studentët lidhur me HIV/AIDS. Kështu, 14% e studentëve janë përgjegjur se do ta mbanit të fshehtë nëse dikush nga familja do ishte HIV pozitiv, vetëm 58.7% e tyre raportojnë se do ta ndanin zyrën apo dhomën me një person HIV pozitiv. Një pjesë mbanin qëndrim mjaft diskriminues duke raportuar se personat HIV pozitiv duhen izoluar (9%) apo nëse një student është HIV pozitiv, nuk duhet të lejohet të frekuentojë shkollën bashkë me të tjerët (11%). Nëse do të marrim në konsideratë edhe numrin e atyre me qëndrime të paqarta (18.8%), të cilët përgjigjen “nuk jam e/i sigurtë”, frekuenca e qëndrimeve negative duhet të jetë edhe më e lartë. Qëndrimet negative, stigmatizuese janë evidente edhe për shumë çështje të lidhura me HIV/AIDS. Lidhur me përdorimin e prezervativit gjatë marrëdhënieve seksuale me një partner rastësor, 569 studentë janë dakord për përdorimin e prezervativit, 56 persona u shprehën se janë disi dakord dhe 9 të intervistuar shprehën se nuk janë aspak dakord, duke i vendosur nën rrisht për infektim me HIV.

Një nga informacionet që ne kërkonim të merrnim nga ky studim ishte dhe ai i lidhur me eksperiencat seksuale të të rinjve. Moshë e kryerjes së marrëdhënies së parë seksuale varion nga 13 vjeç deri 25 vjeç. Moshë minimale e fillimit të marrëdhënies seksuale e raportuar është nën 13 vjeç dhe kjo konfirmon faktin se të rinjtë shqiptarë po hyjnë në marrëdhënie seksuale në një moshë gjithmonë e më të re. Moshë mesatare e kryerjes së marrëdhënies së parë seksuale prej studentëve rezultoi të ishte 18.5 vjeç. Evidencat botërore tregojnë se moshë e fillimit të marrëdhënies seksuale është ulur dhe numri i rasteve me IST, përfshi HIV ndër adoleshentët është në rritje <sup>(5)</sup>.


Studentët të cilët pohuan se kishin kryer marrëdhënie seksuale, u pyetën lidhur me përdorimin e prezervativit gjatë kryerjes së marrëdhënies seksuale.

Siç mund të vihet re nga grafiku 1, vetëm 26% e studentëve përdorin gjithmonë prezervativ gjatë marrëdhënies seksuale, 39% raportuan se nuk përdorin asnjëherë prezervativ dhe 35% kanë pohuar se e përdorin prezervativin me raste.




### Grafiku 1. Përdorimi i prezervativit gjatë marrëdhënies seksuale

Në grafikun e mëposhtëm, nr 2, paraqiten të dhëna mbi përdorimin e prezervativit gjatë marrëdhënies së fundit seksuale. Vetëm 33.8% e të intervistuarëve kanë përdorur prezervativ gjatë marrëdhënies së tyre të fundit seksuale dhe shumica e tyre, 66.2% e tyre nuk kanë përdorur atë. Ky rezultat konfirmon prezencën e lartë të sjelljeve me risk dhe kjo gjetje merr rëndësi për faktin se seksi pa prezervativ është rruga primare e transmetimit të virusit HIV.



### Grafiku 2. Përdorimi i prezervativit gjatë marrëdhënies së fundit seksuale

Më tepër se gjysma e studentëve pjesmarrës në studim (54%) e kanë përdorur prezervativin për parandalimin e një shtatzënie të padëshiruar dhe jo për të parandaluar një IST. Siç, shihet në grafikun 3, arsye kryesore për mospërdorimin e prezervativit ishte pasja vetëm një partneri seksual (51.7%), për 5.8% arsyeja ishte ulja e kënaqësisë seksuale dhe arsye të tjera ishin: “nuk di ta përdor”, “nuk kam besim se të mbrojnë”, “kam turp ta blej”. Rreth 89% e studentëve preferojnë farmacitë për të siguruar prezervativ, 1.6% e tyre drejtohen në qendrën e planifikimit familjar, 10.1% u drejtohen supermarketeve dhe 9.3% e tyre nuk dinin ku ti siguronin.



### Grafiku 3. Përdorimi i prezervativit gjatë marrëdhënies së fundit seksuale

Pyetjes “a keni kryer ndonjëherë testin për HIV?”, 90.1% janë përgjigjur negativisht, e dhënë e ngjashme kjo me studime në vende të tjera <sup>(15)</sup>. Arsyet e moskryerjes së një testi rutinë ishin: frika nga rezultati i testit (3,3%), frika nga diskriminimi në rast rezultati pozitiv (1,4%), frika se stafi shëndetësor nuk do ruaj konfidencialitetin (2,1%) dhe 62.1% mendojnë se nuk e kanë të nevojshme mbasi janë të shëndetshëm. Së fundmi, studentët janë pyetur “ku mund të shkojë një person të testohet për HIV?” dhe 35.3% pohuan se mund të drejtohen në QSUT (Qendra Spitalore Universitare Tiranë), 34.2% në institucion mjekësor privat dhe 26.8% referuan Institutin e Shëndetit Publik, dhe 32.2% e studentëve u përgjigjën “nuk e di”.

### Konkluzione

Përgjithësisht studentët kanë informacione të sakta lidhur me HIV/AIDS, por megjithatë një përqindje për tu konsideruar kanë informacion të limituar apo keqkuptime mbi mjaft prej çështjeve të lidhura me HIV/AIDS. Rreth 15.2% pjesmarrësve në studim mendonin se HIV mund të transmetohet gjatë kontaktit të përditshëm me persona të infektuar.

Keqkuptimet dhe qëndrime negative stigmatizuese ndaj personave HIV pozitiv janë ende të përhapura tek studentët - 9% e tyre shprehen se personat HIV pozitiv duhen izoluar, 11% raportojnë se nuk duhet të lejohen të frekuentojnë shkollën, dhe 14% e studentëve pohojnë se do ta mbanit të fshehtë nëse dikush nga familja do ishte HIV pozitiv.

Mosha e kryerjes së marrëdhënies seksuale është spostuar drejt moshave më të reja. Mosha minimale e kryerjes së marrëdhënies së parë seksuale ishte nën 15 vjeç dhe mosha mesatare 18.5 vjeç. Mbi 1/3 e të intervistuarve (39.4%) nuk përdorin prezervativ, ose nuk e përdorin atë në mënyrë konsistente. Kështu 66.2% e tyre nuk kanë përdorur prezervativ gjatë marrëdhënies së fundit seksuale. Më tepër se gjysma e studentëve (56.5%) kanë përdorur prezervativ për të parandaluar një shtatzëni dhe jo për tu mbrojtur nga një IST përfshi HIV. Studentët e përfshirë në studim nuk janë të ndërgjegjësuar për rëndësinë e kryerjes së ekzamineve rutinë, megjithëse kanë raportuar kryerjen e sjelljeve seksuale me risk. Shumica e tyre, 90.1% nuk kanë kryer asnjëherë testin për HIV.